



BULETIN INFORMATIV

TETOR - DHJETOR 2024

Komisioni Kombëtar Rregullator miraton Strategjinë Institucionale për 2025-2027

Komisioni Kombëtar Rregullator ka miratuar Strategjinë Institucionale për vitet 2025-2027. Qëllimi i këtij dokumenti është përcaktimi i objektivave strategjike dhe aspekteve kryesore të veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit për periudhën 2025 - 2027 në kuadër të zhvillimit të sektorit të ujit në kontekstin kombëtar, harmonizimit me direktivat e Bashkimit Evropian dhe sfidave që paraqiten nga ndryshimet klimatike. Hartimi i “Strategjia Kombëtare e Sektorit të Furnizimit me Ujë të Pijshëm, Grumbullimit, Largimit e Trajtimet të Ujërave të Ndotura Urbanë për vitet 2023 – 2030” evidentoi nevojën për të konkretizuar jo vetëm reformën dhe riorganizimin e sektorit, por edhe në përcaktimin e objektivave për garantimin e ofrimit të një shërbimi gjithëpërfshirës, të qëndrueshëm dhe cilësor, me tarifa të përballueshme, në respektim të shëndetit publik, mirëqenies, mjedisit dhe në përmbushje të angazhimeve të marra për përmbushjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Strategjia Institucionale është e ndarë në dy drejtime kryesore: Objektivat strategjike, që përfshijnë të gjithë aktivitetet e rregulluara të sektorit të furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të Ndotura dhe Plani i veprimit, i cili përshkruan masat, aktivitetet kryesore dhe afatet kohore që ERRU synon të përdorë për realizimin e secilit objektiv strategjik si dhe produktin final. Objektivat strategjike dhe plani i veprimit përfaqësojnë pikat kryesore në të cilat synohet të jetë veprimtaria e ERRU-së për tre vitet e ardhshme, por mund të zgjerohen edhe me veprimtari të tjera, të cilat plotësojnë kuadrin rregullator. [Dokumenti i plotë](#)

PËRMBAJTJA

- STRATEGJIA INSTITUCIONALE 2025-2027
- VENDIMET E KKRR
- PJESËMARRJA NË KONFERENCA
- TRAJNIME E SEMINARE



VENDIMET E KKRR

Nga muaji tetor deri në dhjetor të vitit 2024, Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar katër mbledhje, në të cilat ka miratuar disa vendime, midis të cilëve veçojmë:

- ✓ Vendim mbi miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut për Entin Rregullator të Ujit 2025-2027
- ✓ Vendim mbi Miratimin e përqindjes së pagesës rregullatore vjetore
- ✓ Vendim “Për një ndryshim në Metodologjinë e Tarifave të Shërbimeve Ujësjellës Kanalizime”
- ✓ Vendim “Për fillimin e procedurës për nivel të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Berat sh.a”
- ✓ Vendim “Për fillimin e procedurës për nivel të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan sh.a”
- ✓ Vendim “Për miratimin e nivelit të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Gjirokastrë sh.a”
- ✓ Vendim “Për ndryshimin e drejtuesit ligjor për Shoqërinë Rajonale UK Kukës sh.a”
- ✓ Vendim “Për miratimin e nivelit të ri tarifor të Shoqërisë Rajonale UK Shkodër sh.a”
- ✓ Vendim mbi raportin e Bilancit të Ujit të shoqërive UK për vitin 2023
- ✓ Vendim mbi aplikimin “Për licencim për herë të parë të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë sh.a”
- ✓ Vendim mbi aplikimin për rinovim licence për Shoqërinë Ujësjellës Kanalizime Vorë
- ✓ Vendim mbi aplikimin “Për rinovim licence për përfundim afati të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a”
- ✓ Vendim mbi aplikimin “Për rinovim licence të Shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Tiranë për efekt të ndryshimit të Drejtuesit Ligjor”

LICENCA

Në sektorin e ujit operojnë aktualisht 17 shoqëri ujësjellës kanalizime, 14 prej të cilave tëlicencuara si shoqëri rajonale dhe 3 shoqëri të tjera UK: Tiranë, Vorë dhe Kamëz. Me licencimin për herë të parë të Shoqërisë Rajonale UK Vlorë në tre mujin e fundit të vitit 2024 ka shkuar në 14 numri i shoqërive rajonale, ndërkohë që përgjatë kësaj periudhe ka patur disa ndryshime në licencimin e shoqërive Tiranë e Kukës si pasojë e ndërrimit të drejtuesit ligjor si dhe është rinovuar licenca e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sh.a pas përfundimit të afatit.

TARIFA

Në 3-mujorin e fundit të vitit 2024, Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) ka miratuar tarifat e reja për Shoqëria Rajonale UK Shkodër sh.a dhe Shoqëria Rajonale Gjirokastrë sh.a si dhe ka hapur procedurën për aplikimin për nivel të ri tarifor për dy shoqëri të tjera: Shoqëria Rajonale Berat sh.a dhe Shoqëria Rajonale Elbasan sh.a, ndërkohë që ka në proces analize propozimin për nivel të ri tarifor nga Shoqëria Rajonale Korçë sh.a. Me vendimet e marra përgjatë këtij viti kalendarik, numri i shoqërive rajonale që operojnë me tarifa të reja ka arritur në gjashtë të tilla.

OECD zhvillon takimin e 23-të të Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë

Në datat 18-19 nëntor, në Paris u mbajt Takimi i 23-të i Rrjetit të Rregullatorëve Ekonomikë (NER) të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), në të cilën mori pjesë një përfaqësi e lartë nga Enti Rregullator i Ujit: Znj. Evis Shurdha dhe Znj. Ediola Braha, Anëtarë të Komisionit Kombëtar Rregullator, Znj. Fatime Imeraj, Sekretar i Përgjithshëm dhe Znj. Malvina Zaja, specialiste ligjore. ERRU ishte pjesë e tryezës së diskutimeve të NER, të cilat u fokusuan në: Qeverisjen e rregullatorëve në kontekste të ndryshme; Rregullatorët si komunikues; Drafti i Parimeve të Praktikave më të mira mbi lejet dhe licencimet. Delegatët pjesëmarrës nga shumë vende të botës ndanë eksperiencat e tyre për sisteme efektive licencimi, të cilat duhet të jenë bazuar në rrisqe dhe orientuar drejt rezultatit. OECD mbledh dy herë në vit Rrjetin e Rregullatorëve



Ekonomikë (NER), një platformë e krijuar për të nxitur dhe promovuar dialogun, sfidat dhe zgjidhjet inovatore midis 70 rregullatorëve ekonomikë nga vende dhe sektorë të ndryshëm si komunikacioni, energjia, transporti dhe uji.



Enti Rregullator i Ujit merr pjesë në mbledhjen e 33-të të Asamblesë së Përgjithshme të WAREG

Shoqata e Rregullatorëve Evropianë të Ujit (WAREG) zhvilloi në 11 dhjetor mbledhjen e 33-të të Asamblesë së Përgjithshme, në të cilën Enti Rregullator i Ujit (ERRU) mori pjesë me një përfaqësi të kryesuar nga Znj. Fatime Imeraj, Sekretar i Përgjithshëm. Dita e parë u fokusua në çështjet organizative, nga festimet e 10-vjetorit të WAREG te zgjedhjet e anëtarëve të Bordit që do të shërbejë deri në vitin 2026. Ndërsa ditën e dytë të takimit u prezantua dokumenti i WAREG “Nga efikasiteti i energjisë te neutraliteti klimatik në sektorin e ujit”. Në një tryezë të rrumbullakët përfaqësues nga Parlamenti dhe Komisioni Evropian, Banka Evropiane e Investimeve rregullatorë dhe anëtarë bordi të WAREG sollën në diskutim ndryshimet klimatike në sektorin e ujit, mjetet për rregullatorët në mbështetjet të tranzicionit nga eficaenca e energjisë te neutraliteti klimatik, investimet dhe qeverisja në sektor.

ERRU në Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike të SHUKOS & SHUKALB

Për të dymbëdhjetin vit, në datat 5 deri 7 nëntor shoqatat ujësjellës kanalizime në Shqipëri e Kosovë, SHUKALB dhe SHUKOS organizuan Konferencën dhe Ekspozitën e Përbashkët Ballkanike, në të cilën morën pjesë edhe një përfaqësi nga Enti Rregullator i Ujit. Në këtë event që mbledhi për tri ditë qindra pjesëmarrës nga sektori i ujit, ERRU u paraqit me një prezantim “Reforma në sektorin e ujit: Përmbushja e kuadrit rregullator dhe ndikimi në performancë”. Drejtori i Drejtorisë Tekniko-Ekonomike, Z. Sokol Kraja bëri një pasqyrim të situatës së sektorit UK pas reformës së ndërmarrë nga qeveria qendrore në maj të vitit 2022, parë nga pikëpamja rregullatore në drejtim të përmbushjes së kërkesave ligjore të ERRU-së si dhe impakti fillestar i reformës në drejtim të përmirësimit të performancës së sektorit. Procesi i riorganizimit dhe realizimit me sukses të reformës, nënvizoi Z. Kraja, ka qenë një proces kompleks me shumë sfida dhe të panjohura gjatë implementimit në terren. Konferenca solli edhe shumë takime me



synimin për të nxitur një qasje të koordinuar për zhvillimin e kapaciteteve në fushën e ujërave mes aktorëve kombëtarë dhe rajonalë duke lehtësuar shkëmbimin e njohurive duke diskutuar mekanizmat inovativë dhe promovuar praktikat më të mira.



Trajtimi i Ujërave të Ndotura, ERRU pjesë e seminarit të BE “CrossWater”

“Trajtimi i Ujërave të Ndotura: Projektimi i procesit dhe Menaxhimi i Rikuperimit të tyre” ishte tema e seminarit të zhvilluar në nëntor, si pjesë e projektit “CrossWater” të Bashkimit Evropian. Enti Rregullator i Ujit u bë pjesë e seminarit me dy përfaqësues nga Drejtoria Tekniko – Ekonomike, Z. Sokol Kraja, drejtor Drejtorie dhe Znj. Etleva Demiri, Përgjegjëse e Sektorit Teknik dhe Licencave, e cila bëri një prezantim mbi situatën e ujërave të ndotura në vend, parë nga këndvështrimi rregullator. Menaxhimi i integruar i mbetjeve; Sfidat e trajtimit të ujërave të ndotura; Ripërdorimi i tyre në bujqësi; Qasja e Bankës Botërore ndaj ripërdorimit të ujit; si dhe Grumbullimi e trajtimi i ujërave të ndotura si përmbushje e një kapitulli të mbyllur e gati për të negociuar me BE-në ish-in disa nga prezantimet e tjera që u sollën në këtë event. Projekti i IPA prej të cilit po përfiton Shqipëria, Italia dhe Mali i Zi, synon të krijojë një sistem efikas në Menaxhimin e Ujërave Ndërkufitare përmes zhvillimit të përbashkët të infrastrukturës dhe teknologjive inovatore si dhe sistemeve të reja të kontrollit.



“Menaxhimi i sektorit të ujit, ndërtimi i kapaciteteve dhe mundësitë e financimit”

Aktorët kryesorë në sektorin e ujit nga qeveria, rregullatorët, ndërmarrjet e ujësjellësve dhe organizatat ndërkombëtare u bënë bashkë në një tryezë për menaxhimin e sektorit të ujit, ndërtimin e kapaciteteve dhe mundësitë e financimit. ERRU mori pjesë me një përfaqësi të kryesuar nga Znj. Fatime Imeraj, Sekretar i Përgjithshëm, Z. Sokol Kraja, Drejtor i Drejtorisë Tekniko-Ekonomike, Znj. Fjola Beqiri, Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Konsumatorit, Znj. Nevila Saliu, Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik dhe Tarifave dhe Znj. Etleva Demiri, Përgjegjëse e Sektorit Teknik dhe Licencave. Në sesionin e parë u prezantuan disa nga arritjet e sektorit dhe praktikat më të mira në menaxhim. Z. Kraja mbajti një prezantim mbi kuadrin ligjor dhe përmirësimet në metodologjinë e tarifave, ndërsa sesioni i dytë ishte i fokusuar në diskutime mbi iniciativat për ndërtimin e kapaciteteve dhe mekanizmat e financimit. Konferenca u organizua nga “Veolia Group”, një kompani franceze e specializuar në shërbimet e sektorit mjedisor dhe SHUKALB.

Seminari i TAIEX mbi Direktivën e Ujit të Pijshëm të BE

Shoqata e Rregullatorëve Evropianë të Ujit (WAREG), në bashkëpunim me rregullatorin portugez (ERSAR) zhvilluan në 21 dhe 22 nëntor seminarin e radhës së Programit TAIEX të Komisionit Evropian ku Enti Rregullator i Ujit ishte prezent me një grup pune. Seminari trajtoi Direktivën e Ujit të Pijshëm, roli që luan rregullatori në monitorimin e efikasitetit dhe investimeve, në hartimin e Treguesve Kryesorë të Performancës, monitorimin e tyre dhe sfidat që burojnë nga detyrat që dikton Bashkimi Evropian. Neutraliteti i energjisë në sistemet e ujit ishte një tjetër temë prezantimi me rëndësi në këtë seminar. Ekspertët diskutuan se si arrihet ajo, me qëllim për të shkuar drejt neutralitetit klimatik duke reduktuar përdorimin e



energjisë. Në seminar u fol edhe mbi përdorimin e teknologjive inovative si: rrjetet inteligjente të ujit, metodat e AI, zëvendësimi i mjeteve që bëjnë reduktimin e presionit të ujit.

